



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 604/5 prot.

Tiranë më 03.05.2024

VENDIM

Nr. 08, datë 03.05.2024

PËR KONTROLLUESIN

“ZYRA VENDORE ARSIMORE PARAUNIVERSITARE TIRANË”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Zyra Vendore Arsimore Parauniversitare, Tiranë” (në vijim, “Kontrolluesi/ZVAP”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 56, datë 29.02.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetim administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi ushtron aktivitetin si institucion arsimor publik, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare

në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit nr. 343, datë 19.08.2013 “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, Urdhrit nr. 234, datë 19.04.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar”, Urdhrit nr. 773, datë 20.09.2019 “Për miratimin e përshkrimeve të vendeve të punës për punonjësit e DPAP, DRAP dhe ZVAP”, si dhe Vendimit nr. 99, datë 27.02.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”.

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategoritë e subjekteve të të dhënave, si: “punonjës”, “nxënës”, “nxënës me aftësi të kufizuara”, “mësues”. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

2. Rezulton se, në datë 28.02.2024, nga burime të ndryshme informacioni dhe media audio-vizive, në zonën e Alliasit Tiranë, janë hedhur në vende publike, dosje dhe dokumente, në përmbajtje të të cilave gjenden, ndër të tjera, dhe informacione mbi të dhënat personale të subjekteve të lartpërmendura.

Në këtë kuadër, Zyra e Komisionerit ka nisur hetimin administrativ kryesisht në lidhje me dosjet dhe dokumentacionin nga konstatimet në terren dhe verifikimi i kryer nga ana e grupit të kontrollit, rezulton se të dhënat i përkasin disa shkollave 9-vjeçare të Qytetit të Tiranës, përkatësisht të periudhës kohore midis viteve 2012-2019 dhe ato përmbajnë: “*certifikate familjare, certifikate personale, raport mjekoligjor, vërtetim banimi, vërtetim nxënësi, kartelë personale e punëkërkuessit, fotografi, vërtetim tatimesh, etj*”. Duke marrë në konsideratë faktin e përmbajtës së dokumentacionit në këto dosje, si dhe rëndësisë e të dhënave, Zyra e Komisionerit ka vijuar me hetimin administrativ për disa Kontrollues, ndër të tjera, dhe për ZVAP Tiranë, si institucion përgjegjës në bazë të legjislacionit specifik.

Gjithashtu, rezulton se janë vetë Institucionet Arsimore (në vijim, I/A) Shkollat që administrojnë dokumentacionin përkatës të dosjeve të nxënësve dhe nëpërmjet ZVAP përcjellin dokumentacionin e listuar më sipër pranë, Drejtorisë së Përgjithshme të Kopshteve dhe Çerdheve të Bashkisë Tiranë (në vijim, D.P.Ç.K.), vetëm në raste specifike, konkretisht për përfitimin e stimujve financiarë, të dhëna, për nxënësit ekselentë të shkollave të ciklit të mesëm e të ulët.

Nga provat e administruara gjatë hetimit administrativ të ushtruar pranë D.P.Ç.K, në zbatim të Urdhrit nr. 57, datë 29.02.2024 të Komisionerit, rezultoi se faturat e arkëtimit të lëshuara nga D.P.Ç.K. për përfitimin e stimujve financiarë, provojnë se dokumentacioni i administruar, korrespondon me dokumentacion e përhapur në ambientet publike. Këto të dhëna, përkojnë në vite dhe në përmbajtje me kategoritë e të dhënave që D.P.Ç.K. përpunon dhe administron, në kuadër të përmbushjes së detyrimeve të legjislacionit specifik.

Për sa më sipër, rezultoi se në këtë rast nuk është ZVAP institucioni përgjegjës për përhapjen e paligjshme të dokumentacionit të viteve 2012-2019 që i përket disa shkollave 9-vjeçare të qytetit të Tiranës.

3. Përsa i përket detyrimeve të tjera që ZVAP ka në përmbushje të detyrimeve të parashikuara në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, rezulton se Kontrolluesi disponon llogari në platformën “Facebook”, në të cilat pasqyron aktivitete të zhvilluara, ndër të tjera, duke i ilustruar/publikuar online, përmes fotografive dhe videove të subjekteve të të dhënave (*punonjës, nxënës, mësues*), të marra gjatë aktiviteteve mësimore, kulturore, festa, etj.

Konstatohet se, ZVAP nuk aplikon marrjen e pëlqimit ndaj subjekteve të të dhënave, për publikimin e pamjeve fotografike dhe videove në rrjetet sociale që administron, në kundërshtim me parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave, të parashikuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 4, datë 16.03.2010 të Komisionerit “Për marrjen e masave të sigurisë së të dhënave personale në veprimtarinë e fushës së arsimit”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 4”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, publikimi i fotografive të nxënësve në platformat “Facebook” dhe “Instagram” konsiderohet përpunimi i të dhënave personale të subjekteve të të dhënave dhe legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kriteret ligjore të përpunimit. Në këtë rast, gërma a, e pikës 1, të nenit 6, të Ligjit, a) *nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin.*

Dhënia e “Pëlqimit”, referuar përkufizimit të parashikuar në pikën 24, të nenit 3 të Ligjit duhet të jepet në formë deklarative shkresore, shprehimisht, me vullnet të plotë e të lirë, si dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen.

4. Kontrolluesi, nëpërmjet postës elektronike të datës 18.03.2024, ka deklaruar se, institucioni nuk disponon më një faqe zyrtare të internetit. Megjithatë, nga verifikimet e grupit të kontrollit rezulton se, Kontrolluesi disponon faqen zyrtare <https://zvatirane.edu.al>, në të cilën nuk ka publikuar rubrikën “Politikat e privatësisë”.

Konstatohet se, subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërmbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të

të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

5. Kontrolluesi disponon rregullore *“Për përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale në Zyrën Vendore Arsimore Tiranë”*, por nga analizimi i përmbajtjes së saj konstatohet se, rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, në të cilin të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënave), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., si një detyrim mjaft i rëndësishëm, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

6. Rezulton se Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit të Menaxhimit së Sigurisë së Informacionit (SMSI), lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 *“Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha”*, (në vijim, “Udhëzimi nr. 47”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit. Për më tepër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, marrja e masave për zhvillimin dhe dokumentimin e trajnimeve të përshtatura për punonjësit, që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, është një nga masat e sigurisë së të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Për më tepër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI, në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dorëzuar kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit. Përfaqësuesi i Kontrolluesit u paraqit në seancë dëgjimore, gjatë së cilës parashitri qëndrimin e tij, si vijon: *“Në vijim të detyrave të lëna në këtë proces-verbal, ZVAP Tiranë do të nxjerr një urdhër për të ndërhyrë me plan konkret për rikuperimin e gjetjeve të lëna nga grupi i hetimit administrativ”*.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e Kontrolluesit marrja e masave konkrete teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektsh të dhënash), sigurinë e të dhënave, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të gërmave “a”, “b” dhe “dh”, të pikës 1, të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe kritereve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjen e masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

Gjithashtu, ndaj këtij Kontrolluesi është kryer hetim administrativ i mëparshëm nga Zyra e Komisionerit, nga ku ka rezultuar se për disa nga detyrat e lëna nuk janë marrë masa për rikuperimin e tyre sipas Vendimit nr. 59, datë 14.12.2021 të Komisionerit.

Vendimi i Komisionerit bazohet gjithashtu në faktin që, Kontrolluesi ka qenë edhe më parë subjekt i kontrollit nga ana e Zyrës së Komisionerit dhe për rrjedhojë rezultoi përsëritës për disa nga shkeljet e mësipërme. Konkretisht, nuk janë përmbushur nga ana e Kontrolluesit detyrimet e parashikuara në nenin 5, 18 dhe 27 të Ligjit.

Kontrolluesi, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI, në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, detyrim ky i cili i është ngarkuar Kontrolluesit edhe nga hetimi administrativ i mëparshëm të kryer nga Zyra e Komisionerit, i cili nuk është përmbushur akoma nga Kontrolluesi.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 27, 29, 30, 31, 39 pika 1, germat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit dhe Udhëzimi nr. 4, Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit.

V E N D O S A:

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 18 të Ligjit;
3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40.000 (dyzet mijë) Lekë, për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të sanksionuara në nenet 5 dhe 6 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave për të gjitha proceset përpunuese, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
6. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për përshtatjen e rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
7. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;

8. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet sipas këtij akti, brenda afateve, si vijon:
- vazhdimisht, detyrimin e përcaktuar në pikat 4 dhe 5 më sipër;
 - brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e parashikuar në pikën 6 më sipër.
 - brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 7 më sipër.
9. Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
10. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
11. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbartimit;
12. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot, më datë 03.05.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi